



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA V

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Integrime Evropiane

Mbledhja nr. 31.

Prishtinë, më 06.11.2015 në orën 10:00.

Ndërtesa e Kuvendit, sala S-1

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR INTEGRIME EVROPIANE

Në mbledhje morën pjesë: Teuta Sahatqija, Luljeta Gutaj -Veselaj, Rustem Mustafa, Vjosa Osmani, Arben Gashi dhe Slllobodan Petroviq.

Munguan: Xhavit Haliti, Ilir Deda, Valdete Bajrami, Time Kadrijaj dhe Kujtim Paçaku.

Nga Staf i Mbështetës i Komisionit: Ahtere Loxha, Adelina Demolli, Safet Beqiri dhe Florent Mehmeti.

Mbledhjen e kryesoi znj. Teuta Sahatqija, kryetare e Komisionit.

Në mbledhje u propozua ky :

Rend i Ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i Procesverbalit nga mbledhjet e datës 14.7.2015, 28.07.2015 dhe 7.9.2015;
3. Shqyrtimi i Projektligjit Nr. 05/L-042, për rregullimin e shërbimeve të ujit, me amendamentet e Komisionit Funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;
4. Shqyrtimi i Projektligjit Nr. 05/L-18, për Provimin e Maturës Shtetërore, me amendamentet e Komisionit Funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;
5. Shqyrtimi i Projektligjit Nr. 05/L-045, për Sigurimet, me amendamentet e Komisionit Funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;
6. Të ndryshme.

Kryetarja e Komisionit, Teuta Sahatqija, pasi konstatoi se janë plotësuar kushtet për punë e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i Rendit të ditës;

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i Procesverbalit nga mbledhjet e datës 14.7.2015, 28.7.2015 dhe 7.9.2015;

Kryetarja konstatoi se Procesverbalet nga mbledhjet e datës 14.7.2015, 28.7.2015 dhe 7.9.2015 u miratuan pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Projektligjit Nr. 05/L-042, për rregullimin e shërbimeve të ujit, me amendamentet e Komisionit Funkcional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;

Kryetarja prezantoi opinionin ligjor të Projektligjit Nr. 05/L-042, për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit, së bashku me amendamentet e Komisionit Funkcional, pasi janë shqyrtuar dispozitat e Projektligjit, është konstatuar se fusha të cilën e rregullon ky projektligj, nuk është në kundërshtim me parimet e legjislacionit të BE-së, përkatësisht Acquis të BE-së,

Lidhur me këtë projektligj e hapi diskutimin.

Kryetarja konstatoj se komisioni njëzëri nxori këtë:

Rekomandim

Projektligji Nr. 05/L-042, për rregullimin e shërbimeve të ujit, me amendamentet e Komisionit Funkcional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së, nuk është në kundërshtim me parimet e legjislacionit të BE-së, përkatësisht Acquis të BE-së, mund të rekomandohet për miratim në procedurë të rregullt në Kuvend.

4. Shqyrtimi i Projektligjit Nr. 05/L-18, për Provimin e Maturës Shtetërore, me amendamentet e Komisionit Funkcional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;

Kryetarja theksoi se Projektligji Nr. 05/L-18, për Provimin e Maturës Shtetërore, së bashku me amendamentet e Komisionit Funkcional, janë shqyrtuar dhe pasi është konstatuar se fusha e cila rregullon ky projektligj nuk është në kundërshtim me parimet e legjislacionit të BE-së, përkatësisht Acquis të BE-së,

Lidhur me këtë hapi debatin.

Kryetarja konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

Rekomandim

Projektligji Nr. 05/L-18, për Provimin e Maturës Shtetërore, së bashku me amendamentet e Komisionit Funkcional, nuk është në kundërshtim me parimet e legjislacionit të BE-së, përkatësisht Acquis të BE-së, mund të rekomandohet për miratim në procedurë të rregullt në Kuvend.

5. Shqyrtimi i Projektligjit Nr. 05/L-045, për Sigurimet, me amendamentet e Komisionit Funkcional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;

Kryetarja theksoi se Projektligji Nr. 05/L-045, për Sigurimet përcakton parimet dhe rregullat themelore për licencimin, rregullimin dhe mbikëqyrjen e siguruesve, risiguruesve, ndërmjetësuesve të sigurimeve dhe subjekteve tjera të parapara me këtë Ligj, në mënyrë që

industria e sigurimeve në Republikën e Kosovës, të operojë në mënyrë të sigurt, të qëndrueshme dhe transparente, në mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të mbajtësve të policave.

Burimet sekondare e legjislacionit të BE-së që rregullojnë këtë fushë, janë si vijon;

1. Direktiva Nr. 2009/138/EC lidhur me ushtrimin dhe ndjekjen e biznesit të sigurimeve dhe risigurimeve; dhe
2. Direktiva 2002/92/ EC për ndërmjetësimin dhe sigurimet.

Projektligji Nr. 05/L-045, për Sigurimet me amendamentet e Komisionit FunkSIONAL, janë shqyrtuar dhe është konstatuar se fusha e cila rregullon ky projektligj rregullohet me legjislacion të BE-së, përkatësisht Acquis të BE-së. Ky projektligj në masë të madhe inkorporon dispozitat të Acquis dhe mund të rekomandohet për miratim në procedurë të rregullt në Kuvend.

Lidhur me këtë projektligj hapi diskutimin

Kryetarja konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

Rekomandim

Projektligji Nr. 05/L-045, për Sigurimet me amendamentet e Komisionit FunkSIONAL, janë shqyrtuar dhe është konstatuar se fusha e cila rregullon ky projektligj, rregullohet me legjislacion të BE-së, përkatësisht Acquis të BE-së dhe si i tillë mund të rekomandohet për miratim në procedurë të rregullt në Kuvend.

Të ndryshme.

Kryetarja lidhur me këtë pikë, pyeti anëtarët nëse kishin ndonjë çështje për të ngritur .

Arben Gashi- për sqarim tha se kishte prit që në mbledhje të ishte edhe z.Xhavit Haliti në komision sepse është diskutuar pa prezencën time para disa javësh në një mbledhje të Komisionit. Paraprakisht kam njoftuar komisionin një ditë përpara se nuk mund të marr pjesë në mbledhje për shkak të agjendës tjetër. Mendoj se Xhavit Haliti ka keqpërdor mikrofoning dhe prezencën e mediave për të krijuar një situatë të palakmueshme për mu Vjosën dhe të tjerët, duke komentuar se ne po vijmë këtu për mëditje dhe se duhet tu hiqen mëditjet, për çka nuk ka të drejt për këtë .

Mbledhja e Komisionit është thirrur një ditë përpara, nuk e kam pas problem se kur është bërë thirrja sepse kam pas agjendë tjetër dhe Xhavit Haliti ka bërë gabim me sjelljen që ka bërë dhe ka krijuar situatë të panevojshme zyrtare në Komision sepse ka qenë deklarim zyrtar, sepse po të kishte qenë deklarim privat, kishim biseduar privatisht. E bëra këtë vetëm sa me e pas të qartë ju si komision, sepse nuk pres ndonjë reagim prej jush.

Luljeta Gutaj- njoftoi komisionin për mbajtjen e dëgjimit publik që do të bëhet më 11 nëntor prej orës 10, sepse është përfunduar monitorimi i Projektligjit për parandalimin e trafikimit me qenie njerëzore dhe ftoi anëtarët të marrin pjesë, ku siç tha ky janë të ftuar përfaqësuesit e institucioneve relevante, të cilët kanë ndikim të drejtpërdrejtë në zbatimin e këtij ligji

Vjosa Osmani- Kërkoj që nëse diçka diskutohet zyrtarisht në Komision, edhe përgjigja duhet të bëhet zyrtarisht në komision. Nëse ndonjëri prej anëtarëve të Komisionit jep ide dhe sqarime për një çështje të caktuar në Komision, ju kisha lutur që nëse si anëtar keni komente rreth një ideje, atëherë do të ishte shumë kolegiale që komentet që i ka dhënë Arbeni ose unë të jepen në komision, sepse po dëgjoj komente rreth pyetjes sime drejtuar z.Zhbogar në takimin e kaluar, për

dërgimin e çështjes së Asociacionit në Komisionin e Venedikut, kinse kjo kërkesë qenka që lëndën me dërgua te Enver Hasani dhe këto çështje po i dëgjoj nga anëtarët e komisionit e që kjo është absurditeti më i madh që e kam dëgjuar unë në karrierën time politike. Kushdo që lexon pak dhe e merr guximin me fol në këtë komision, e din shumë që me hy në ueb faqen e Komisionit të Venedikut, e shihni se i ka 60 anëtarë dhe se Enver Hasani nuk merr vendim aty vetëm, për cilëndo çështje që e dërgojnë. Gati të gjithë zyrtarët e lartë institucionalë kanë bërë deklarata publike rreth kredibilitetit të këtij institucioni. Të shfrytëzosh mekanizmat ndërkombëtarë në të cilën si Republikë e Kosovës je anëtarësuar, nuk do të thotë që nuk po vepron si shtet por e kundërta, je duke vepruar si shtet. Komisioni i Venedikut që jep mendime profesionale, nuk kërkon që me u shtjerr mjetet juridike dhe arsyeja që herën e kaluar e përmenda këtë çështje, nuk ka të bëjë me atë se çka mendoj unë personalisht për Gjykatën Kushtetuese sepse kjo është tërësisht jorelevante për momentin në të cilën ne gjendemi, por ka të bëjë me deklaratimet që i kemi dëgjuar nga njerëzit që e kanë shkaktuar krizën rreth asaj se çka ata mendojnë për Gjykatën Kushtetuese. Tani që të keqinterpretohet tërësisht në mënyrë kaq absurde nga anëtarët e komisionit, që nuk e marrin guximin që të flasin këtu rreth ideve që i prezantojmë, vërtet është për të ardhur keq. Pra, kërkesa ime është që nëse keni diçka për të thënë rreth ideve që propozohen këtu në komision, është mirë që këtu t'i diskutojmë dhe t'i sqarojmë sepse nuk jemi armiq dhe po shohim në çfarë shtate na kanë sjell pikërisht fjalitë pas shpine, duke mos u ul ne tryezë të flasim bashkë..

Teuta Sahatqija –Sa i përket mbledhjes së kaluar, në rend dite ka qenë shqyrtimi i MSA-së dhe secili anëtarë e ka të drejtën me propozua dhe me diskutua ose jo, kurse për Komisionin e Venedikut nuk keni folur vetëm ju znj. Vjosa, por ka pasur edhe shumë analistë, të cilët kanë folur dhe secili deputet dhe qytetar ka të drejtë të flas, pa kërkuar leje prej askujt.

Vjosa Osmani- u përgjigj, duke thënë se nuk ka qenë aspak jashtë prej rendit të ditës sepse z. Zhbogar, 70% të fjalimit të tij e ka pas për krizën politike dhe mjetet për me dal prej krize, kështu që pyetja ime drejtuar atij ka qenë rreth asaj që ai e përmendi. Kurse unë po flasë për anëtarët e këtij komisioni dhe shumë mirë e dimë që në momentin kur një anëtar i komisionit propozon diçka, do të ishte kolegjiale që kundërshtimet apo supozimet duhet të thuhesh dhe sqarohen këtu. Ne si përfaqësues të popullit, kemi përgjegjësi shumë më të mëdha se sa qytetarët që mund ti komentojnë veprimet tona dhe kemi obligim më të madh që ti sqarojmë gjërat para njëri tjetrit, para se të flasim prapa shpine për njëri tjetrin.

Rrustem Mustafa- Mendoj se Komisioni për Integritet Evropian, është komision i rëndësishëm dhe mund të japë propozime për daljen nga situata, që është e palakmueshme për ne, sepse ne nuk i kemi shfrytëzuar të gjitha mundësitë që i kemi në tavolinë. Unë, edhe më herët e kam pas përmendur një strategji për me dal nga kjo situatë. Ne e kemi si moment të fundit që mund të shtrojmë kërkesë në BE , si ndërmjetësuese në këto marrëveshje për me dal me interpretimet e tyre, për mos me lejua njerëzit që e bëjnë mjegull në Kosovë për me hap opinione, as Enver Hasanin dhe askënd. Ne mund të japim ide se si të dalim nga kjo situatë.

Mbledhja përfundoi në orën 10:30.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetarja e Komisionit

Teuta Sahatqija